



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Kllokot-Vrbovcë

Data : 06.08.2018

Në bazë të nenit 12, pika 12.2 (c,d), neni 14, pika 14.1;14.2, 14.3, Ligjit për qeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 10. Paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.5. Ligji për dhënjën në shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së palujtshme si dhe statutit komunal Kllokot-Vërbovc: neni 8. Pika 8.1 (c.) neni 13, pika 13.3 (l.), Kuvendi Komunal Kllokot-Vërbovc vendos si më posht :

VENDIM

Për dhënjën e pëlqimit të Kuvendit Komunal për ndërtimin e Stabilimentit elektrik , Trafostacionit nga ana e KEDS-it për ngastrën komunale me nr. 974-55 zona katastrale Kllokot me sipërfaqe 32 m²

Neni 1.

Kuvendi Komunal Kllokot-Vërbovc me datë : 06.08.2018 në seancën e dytë të jashtzakonshme të Kuvendit merr vendim **Për dhënjën e pëlqimit nga ana e Kuvendit komunal për ndërtimin e Stabilimentit Elektrik , Trafostacionit nga ana e KEDS-it në parcellën komunale me nr. 974-55 zona katastrale Kllokot me sipërfaqe 32 m²**

Neni 2.

Në bazë të kërkesës nr : 10787 e regjistruar në arhivën komunale me datë :25.07.2018 nga ana e KEDS-it , Kuvendi komunal Kllokot-Vërbovc ka prurë vendim si në nenin 1 të këtij vendimi i cili do të shfrytëzohet nga ana e KEDS për nevoja të instalimit të Trafostacionit 10(20) /40KV , gjegjësisht S=4x8 I cili është në interes të qytetarëve të komunës si edhe për lidhjen e energjisë elektrike në ndërtesën e re komunale , stacionin policor , dhe Qendrën e Mjeksisë Familjare në Kllokot në një rrjet të rregullt elektrik sipas standardeve dhe kriterjeve të KEDS-it.

Neni3.

Prona e komunës e evidentuar në zonën katastrale në Kllokot në pronësi të komunës Kllokot-Vërbovc sipas listës poseduese nr. P-73701026-00974-55 si dhe kopjes së planit (skicës) 974/55, ipet pëlqimi nga ana e Kuvendit komunal për siopërfaqen prej 32 m² ipet KEDS-it për të ndërruar trafostacionin egzistues me një trafostacion të ri me karakteristika nga neni 2 i këtij vendimi , e cila do të plotësoj standardet dhe kushtet e sistemit të lartë të energjisë elektrike , dhe e cila nuk mund të ndryshoj pronësin .

Neni 4.

Pjesa e cekur e ngastrës nga neni 3 .e Ligjit në fuqi më lart të cekur ,Kuvendi komunal i jep autorizim kryetarit të komunës të nënshkruaj marrveshje për zbatimin e këtij vendimi të Kuvendit në detaje të cilat janë paraparë , nga njëra anë komuna e Kllokotit personi i autorizuar kryetari i komunës ndërsa nga ana e tjetër KEDS si shfrytëzues . Vendimin ta zbatojnë në vepër dhënjën e pronës komunale në raste të veqanta , si dhe të sigurojnë sigurinë e plotë qytetarëve për mbrojtjen e jetës dhe intersave të tyre .

Neni 5.

Të gjitha veprimet juridike për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Kllokot-Vërbovcit dhe drejtorija për kataster , urbanizëm dhe gjeodezi .

Neni 6.

Ky vendim nga neni 1 hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga Kryetari i Kuvendit Komunal të Kllokot-Vërbovcit dhe pas 7 ditëve nga publikimi në faqen e internetit të komunës, ajo fillon me zbatimin e saj.

Kopja :

- MAPL;
- Kabineti i kryetarit të komunës ;
- Drejtori i katastrit , urbanizmit , gjeodezisë
- Kryesuesi i K.K. Kllokot Vërbovc
- Arhivës Komunale

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Kllokot-Vërbovc

Zarko Dejanovic